

V E N D I M
Nr.41, datë 1.11.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datat 25.9.1996 dhe 14.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.39 Akti që i përket :

K Ë R K U E S : SKENDER HASA, banues në Tepelenë.

PALE E INTERESUAR : KESHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Z. Ferdinand Poni.

O B J E K T I

Shfuqizimi i Dekretit nr.1507, datë 17.6.1996 të Presidentit të Republikës “Për shkarkimin e Z.Skënder Hasa nga detyra e kryetarit të Bashkisë Tepelenë, për shkelje të rënda të ligjit”.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Presidenti i Republikës me Dekretin nr.1507, datë 17.6.1996 e ka shkarkuar kërkuesin Skënder Hasa nga detyra e kryetarit të Bashkisë Tepelenë “Për shkelje të rënda të ligjit”. Si bazë për nxjerrjen e këtij Dekreti ka shërbyer propozimi që i ka bërë Presidentit të Republikës, Kryetari i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra me shkresën nr.2160 Prot., datë 14.6.1996, në të cilën parashtrohen një sërë veprimesh ose mosveprimesh të kërkuesit si kryetar bashkie të kryera gjatë vitit 1994 e të konsideruara si shkelje ligji nga një ekip i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit gjatë një kontrolli të kryer në janar të vitit 1995.

Gjykata, pasi administroi e shqyrtoi të gjitha materialet e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit për këtë çështje, arrin në konkluzionin se asnjëra nga shkeljet që i janë atribuar kërkuesit nuk qëndron si e tillë në kuptim të nenit 32 të Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit lokal”, në të cilin përcaktohet : “Kryetari i Komunës ose i Bashkisë mund të shkarkohet me Dekret të Presidentit të Republikës mbi propozimin e motivuar të Kryetarit të Këshillit të

Ministrave, kur kryen akte në kundërshtim me Kushtetutën ose shkelje të rënda të ligjit apo të rendit publik”.

- Kështu, shkeljet që i referohen kërkuesit sipas akt-kontrollit të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit dhe në bazë të tij propozimit për shkarkimin nga detyra, siç janë mosmbajtja e tatimit mbi shpërblimet që i janë dhënë punonjësve të bashkisë në fund të vitit 1994, konvertimi në një rast i lekëve në valutë dhe anasjelltas në subjekt privat pa dëmtuar fare arkën e bashkisë, riparimi i veturës në subjekt privat, të ardhurat e pakëta nga vjelja e taksave në tregun e lirë dhe gabimi i bërë në llogaritjen e dietave vetëm në një rast në shumën gjithsej 10 USD, kanë karakter teknik dhe kanë ardhur jo nga veprimet e kërkuesit, por të punonjësve specialistë, si ai i llogarisë, inspektori i vjeljes së taksave etj. Përveç kësaj, tatimi mbi shpërblimet ju është mbajtur punonjësve një muaj më pas, është bërë kthimi në arkë i 10 USD dhe ndaj inspektorit të vjeljes së taksave është marrë masë disiplinore.

- Në akt-kontrollin e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit dhe propozimin për shkarkimin e kërkuesit parashtrohet se kërkuesi, në kundërshtim me pikën 3 të kapitullit III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 17.8.1993 “Për procedurat e prokurimit me fonde shtetërore”, qëllimisht ka lënë jashtë komisionit zv/kryetarin e bashkisë “për t’i lënë mundësi kryetarit për të manovruar me lehtësi në komision”.

Gjykata konstaton se jo vetëm që supozimi për “manovrimet” të kërkuesit nuk është shoqëruar me asnjë provë, por në dispozitën e sipërpërmendur të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 17.8.1993, caktimi i zv/kryetarit në komisionin e prokurimit “rekomandohet”, pra nuk është i

detyrueshëm. Gjithashtu, ka rezultuar se zv/kryetari i bashkisë shërbente si pedagog në Gjirokastrë, duke e patur kështu të vështirë të merrte pjesë në mbledhjet e komisionit që bëheshin në Tepelenë.

- Sipas akt-kontrollit, tenderat për lyerjen e bashkisë dhe asfaltimin e rrugës “shëtitore nr.2”, janë fituar nga Firma “Stier” duke qenë anëtare e komisionit të prokurimit inxhinierja e bashkisë Znj. Tefta Minxuri, bashkëshortja e titullarit të Firmës “Stier”, çka vjen në kundërshtim me pikën 4 të kapitullit III, sipas së cilës “Asnjë nga anëtarët e komisionit nuk duhet të ketë lidhje legale me konkurruesit. Për këtë qëllim bëhet deklaratë me shkrim nga secili anëtar”.

Siç shihet qartë nga kjo dispozitë, detyrën për të mos marrë pjesë në komision e ka patur vetë anëtarja e komisionit.

- Komisioni i prokurimit të fondeve me procesverbalin datë 25.11.1994 ka shpallur fituese Firmën “Kristal” për zbatimin e punimeve për kanalizimin e ujrave të zeza në shumën 2.86 milion lekë. Këtë vendim të komisionit e ka anulur kërkuesi me vendimin e tij nr.22, datë 5.12.1994 me arsyetimin se afati prej 27 ditësh është i pamjaftueshëm për kryerjen e punimeve. E drejta e kërkuesit për të shqyrtuar ankimet kundër vendimeve të komisionit parashikohet në aneksin 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 17.8.1993.

Supozimi i organit të kontrollit se kërkuesi e ka bërë veprimin e mësipërm “për t’i ardhur në ndihmë ndonjë firme tjetër”, nuk është mbështetur në asnjë provë ose argument.

- Përsa i përket mosmarrëveshjeve që kanë Ndërmarrja Komunale me Firmën “Studio-Projekt” për studimin urbanistik të fushës nën kala të qytetit të Tepelenës, çështja është në shqyrtim në gjykatën e rrethit.

- Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993 “Për masat për zbatimin e Ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”,

kërkuesi si kryetar i bashkisë, me vendimin e tij nr.42, datë 30.7.1993 ka caktuar përbërjen e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve duke mos vënë si kryetare të këtij komisioni sekretarin e këshillit të bashkisë, për faktin se në atë kohë ai ndodhej në kursin e përgatitjes së juristëve. Përveç kësaj, sipas gërmës “b” të pikës 2 të vendimit të sipërpërmendur, caktimi i sekretarit të këshillit të bashkisë si kryetar komisioni nuk është i detyrueshëm. Edhe në këtë rast, dyshimet se kërkuesi ka vepruar “për të patur dorë të lirë”, nuk mbështeten në asnjë provë.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 e vijuesa të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991” Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

Deklarimin e Dekretit nr.1507, datë 17.6.1996 të Presidentit të Republikës për shkarkimin e Z.Skënder Hasa nga detyra e kryetarit të bashkisë Tepelenë, në kundërshtim me Ligjin nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit lokal”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 1.11.1996

MENDIMI PARALEL

Ndonëse bashkohem me konkluzionin përfundimtar të Gjykatës për pranimin e kërkesës së kërkuesit Skënder Hasa, nuk pajtohem përsa i përket motivimit për pranimin e saj.

Ndryshe nga anëtarët e tjerë të Gjykatës, nga vlerësimi i fakteve e rrethanave të verifikuara gjatë shqyrtimit të çështjes, kam arritur në përfundim se gjatë vitit 1994 kërkuesi ka shkelur ligjin në dy raste. Kështu, duke qenë me cilësinë e kryetarit të bashkisë ka lejuar që në komisionin e prokurimit të marrë pjesë një inxhinier e bashkisë, e cila kishte bashkëshort presidentin e Firmës konkurruese e fituese. Ky veprim është në kundërshtim me kërkuesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 17.8.1993.

Po kështu, kërkuesi pa asnjë shkak objektiv për disa muaj nuk ka shpallur tenderin për zbatimin e punimeve lidhur me kanalizimin e ujrave të zeza. Si pasojë, duke bërë shpalljen në fund të

nëntorit 1994, fondi i dhënë ka mbetur pa u përdorur brenda vitit.

Qëndrimet e mësipërme përbëjnë në vetvete shkelje të ligjit, për të cilat kërkuesi ka përgjegjësi. Por, duke marrë parasysh kohën e gjatë që ka kaluar nga kryerja dhe konstatimi i shkeljeve (në fund të vitit 1994 e në fillim të vitit 1995) mendoj se nuk ka vend për marrjen e masave disiplinore ndaj tij.

Masat disiplinore, ashtu siç është përcaktuar për masat e tjera administrative për kundërvajtje, duhet të merren brenda një afati të shkurtër e të arsyeshëm.

K R Y E T A R I
/ **Rustem Gjata** /